



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 2678/2 Prot.,

Tiranë, më 15.07.2024

VENDIM

Nr. 16, datë 15.07.2024

PËR

“TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM TË ZJ.ELSA LITA, PËR TË USHTRUAR DETYRËN E “NËPUNËSIT CIVIL GJYQËSOR”, NË POZICIONIN E PUNËS “SPECIALIST I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, MEDIAN DHE ME JASHTË, NË SEKTORIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, STATISTIKAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, MEDIA DHE ME JASHTË”, PRANË GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR”

Këshilli i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i përbërë nga: **Erjon Bani Kryetar, Erjon Çela Anëtar dhe Saimir Shyti Anëtar**, në mbledhjen e tij të datës 15.07.2024, me propozim të Zëvendëskryetarit të Gjykatës,

KONSTATON SE:

I. FAKTI.

1. Me vendimin Nr. 15, datë 15.07.2024 “Për transferimin e përhershëm të znj.Dinora Aleksi, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit civil gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist Protokolli, në Sektorin e Protokollit, Arkivës”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, Këshilli i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vendosi: [...]

1. Konstatimin e mungesës së plotësimit të kriterëve të vendit të punës nga **znj.Dinora Aleksi**, për pozicionin e punës “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë” pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Transferimin e përhershëm të **znj.Dinora Aleksi**, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit civil gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist Protokolli, në

Sektorin e Protokollit, Arkivës”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kancelari, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve.
4. Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të botohet në faqen zyrtare të Gjykatës.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda afatit ligjor duke filluar ky afat nga nesërmja e komunikimit të këtij vendimi **znj.Dinora Aleksi**.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [...]

2. Ndodhur në këto kushte, rezulton se pozicioni i punës “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë*” pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka mbetur vakant. Për shkak të rëndësisë që ka ky pozicion pune, Këshilli i Gjykatës çmon se ky pozicion pune duhet të plotësohet nëpërmjet transferimit të përkohshëm për një periudhë 6 mujore.

3. Referuar praktikës së shpërndarjes së sekretareve gjyqësore pranë gjyqtarëve si dhe në Kryesekretarinë e gjykatë, Këshilli i Gjykatës konstaton se zj. Elsa Lita nuk është caktuar me gjyqtarët që janë të emëruar pranë kësaj Gjykate. Referuar dosjes personale të zj. Elsa Lita rezulton se kjo e fundit është emëruar në pozicionin e punës “*Sekretare gjyqësore*” pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 13.02.2020 dhe me vendimin Nr. 21/3, datë 02.07.2021 të Këshillit të Gjykatës i është dhënë statusi i nëpunësit civil gjyqësor në këtë pozicion pune.

II. ARSYETIMI JURIDIK.

1. Lidhur me transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil gjyqësor.

4. Në nenin 66 të Ligjit nr. 98/2016 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, nën titullin “**Transferimi i nëpunësve civilë gjyqësorë**”, parashikohet shprehimisht: “**1. Dispozitat e parashikuara në ligjin “Për nëpunësin civil” për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm aplikohen për atë që gjejnë zbatim, përveçse kur në këtë ligj parashikohet ndryshe. 2. Transferimi mund të zbatohet vetëm brenda shërbimit civil gjyqësor.** Nëpunësi civil gjyqësor mund edhe të transferohet përkohësisht për nevojat e gjykatës ose shtetit, në pozicionet që i përshtaten profilit të punës, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është anëtare ose në një institucion ndërkombëtar. **3. Këshilli i Gjykatës, në të cilën nëpunësi civil gjyqësor transferohet, është kompetent për dhënien e vendimit të transferimit.** Në rast transferimi në institucione të ndryshme nga gjykata, organi kompetent që vendos për transferimin është Këshilli i Gjykatës në të cilën është i punësuar nëpunësi civil gjyqësor. Në rastin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor, organi kompetent që vendos për transferimin është Këshilli i Lartë Gjyqësor. 4. Këshilli i Gjykatës njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor në rastet kur nëpunësi civil gjyqësor kërkon transferimin në një institucion tjetër të shërbimit civil gjyqësor për shkak të: a) arsyeve mjekësore ose gjatë shtatzënisë; b) paqftësisë shëndetësore; c) shmangies së një situatë

të vazhdueshme të konfliktit të interesit. 5. Këshilli i Lartë Gjyqësor regjistron nëpunësin civil gjyqësor në listë deri në sistemimin e tij/saj në një pozicion të përshtatshëm. Dispozitat për efektet e pezullimit zbatohen për aq sa është e mundur. 6. Në rast të mbylljes ose riorganizimit të strukturës së gjykatës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ngre Komisionin e Ristrukturimit, sipas ligjit “Për nëpunësin civil”. Komisioni i Ristrukturimit drejtohet nga një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kryetarët dhe kancelarët e gjykatave që i nënshtrohen procedurës së riorganizimit. 7. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton me vendim rregulla më të hollësishme për procedurën e transferimit.”.

4.1. Në Kreun I, nën titullin “TRANSFERIMI I PËRKOHSHËM, të vendimit Nr. 125, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave “PËR TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM DHE TË PËRHERSHËM TË NËPUNËSVE CIVILË”, parashikohet shprehimisht se: “2. **Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas rastiit, përkatësisht brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale, në një institucion të varësisë së institucionit ku është emëruar, në një institucion tjetër të shërbimit civil: a) Në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë 2 viteve; b) Për përmirësimin e rezultateve të tij, deri në 3 (tre) muaj pa ndërprerje gjatë 2 viteve; c) Për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, të përcaktuara nga komisioni kompetent në bazë të ligjeve në fuqi, për aq sa është e nevojshme sipas vendimit të komisionit përkatës.** 3. Në rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, transferimi i përkohshëm nuk bëhet për: a) Nëpunësit civilë në periudhë prove; b) Nëpunësit civilë të emëruar në pozicione të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues, të rekrutuar nga jashtë sistemit të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët nuk kanë plotësuar të paktën një vit pune në pozicionin në të cilin janë emëruar. Në kuptim të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, në periudhën 2-vjeçare të viteve të punës nuk përfshihet koha e periudhës së provës.5. **Transferimi i përkohshëm, në bazë të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, miratohet nga njësi përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet.** Për marrjen e këtij vendimi njësi përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozicionit të punës ku ai kërkohet të transferohet, si dhe në plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe në këtë vendim.9. Nëpunësi civil ka të drejtë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, të refuzojë me shkrim transferimin e përkohshëm pranë njësisë përgjegjëse dhe të dëgjohet prej saj, nëse: a) Gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; b) Vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil. 10. Njësi përgjegjëse merr vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve pas afatit të përcaktuar në pikën 9, të këtij vendimi. **Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës dhe përveç rasteve të parashikuara në pikën 9, të këtij vendimi, është i detyrueshëm.**”.

5. Duke u rikthyer në rastin konkret, Këshilli i Gjykatës çmon se **zj. Elsa Lita** i plotëson kushtet ligjore për t’u transferuar përkohësisht për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit civil gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë” pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo për këto arsye: **së pari,**

plotëson kushtet formale për vendin e punës që është një vit eksperiencë pune dhe arsimi për “Drejtësi”. **Së dyti**, transferimi në rastin konkret zbatohet brenda shërbimit civil gjyqësor. Me vendimin Nr. 21/3, datë 02.07.2021 të Këshillit të Gjykatës zj.Elsa Lita i është dhënë statusi i nëpunësit civil gjyqësor në pozicionin e punës “*Sekretare gjyqësore*” dhe nuk është nëpunës civil gjyqësor në periudhë prove. **Së treti**, për shkak të rëndësisë që ka pozicioni i punës “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë*” çmohet nga Këshilli i Gjykatës që nuk mund të qëndrojë vakant në asnjë moment. Pra, duhet të ushtrojë detyrën në këtë pozicion pune një nëpunës civil gjyqësor tjetër i kësaj gjykate deri në përfundimin e procedurave të lëvizjes paralele. **Së katërti**, zj.Elsa Lita transferohet në të njëjtin vend ku ushtron detyrën e “Sekretares gjyqësore”. Pra, vendi ku transferohet nuk gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil gjyqësor. **Së pesti**, nga dosja personale dhe nga informacionet e marra nga strukturat përgjegjëse nuk konstatohet se zj.Elsa Lita ka probleme shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, që e bën transferimin të pamundur.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Gjykatës, bazuar në nenet 64 pika 2 dhe 66 të Ligjit nr. 98/2016 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; në Ligjin Nr. 95/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*”, i ndryshuar; Ligjin Nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; vendimin Nr. 286, datë 18.12.2019 “*Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*” të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nenin 7 të vendimi Nr. 338, datë 24.9.2020 “*Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata*”, i Këshillit të Lartë Gjyqësor; Vendimin Nr. 148, datë 29.03.2023 “*Për miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e Parë, me Zyrë Shërbimi*”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; në vendimin Nr. 125, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave “**PËR TRANSFERIMIN E PÛRKOHSHËM DHE TË PËRHERSHËM TË NËPUNËSVE CIVILË**” dhe në vendimin Nr. 7, datë 13.06.2024 “*Për një ndryshim në vendimin Nr. 6 datë 07.07.2023, “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” si dhe për miratimin e përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” të Këshillit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*

V E N D O S I:

1. **Zj.Elsa LITA**, transferohet përkohësisht për një periudhë 6 (gjashtë) mujore, për të ushtruar detyrën e “*Nëpunësit civil gjyqësor*”, në pozicionin e punës “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë*” pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kancelari, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve.
3. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të botohet në faqen zyrtare të Gjykatës.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit duke filluar ky afat nga nesërmja e komunikimit të këtij vendimi zj. **Elsa LITA**.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I GJYKATËS

Anëtar/Kancelar

Saimir SHYTI



Kryetar/Zëvendëskryetar

Erjon BANI



Anëtar/Gjyqtar

Erjon ÇELA



